

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“ULUMOTOR Albania” SH.P.K.**

**Neni 1  
Formimi**

Sot me datë 05.02.2024 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “ULUMOTOR Albania” SH.P.K.

Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Halil Ziya ULUBAŞ**, i datëlindjes 05.03.1971, lindur në Aksaray-Turqi dhe banues në Turqi,
2. **Mehmet Arda ULUBAŞ**, i datëlindjes 09.03.1999, lindur në Bahçelievler-Turqi dhe banues në Turqi

**Neni 2  
Selia**


Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “ULUMOTOR Albania” SH.P.K. është në adresën: **Rruga Astrit Losha, Pallati Marituda, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr. 300/142, Kati i pare, Dyqani Nr. 15, Kashar, Tiranë.**

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ULUMOTOR Albania” SH.P.K. është e pacaktuar.

**Neni 4  
Objekti Veprimtarisë**

1. Të importojë dhe eksportojë automjete
2. Të tregtojë Automjete
3. Të importojë dhe eksportojë tregtimi me shumicë dhe pakice i të gjithë llojeve të makinave, pjeseve te kembimit



4. Të importojë dhe eksportojë të tregtojë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e materialeve për stacione karikimi elektrike
5. Të japë makina me qira
6. Të hapë servise makinash dhe të administrojë ato
7. Të japë përfaqësi ekskluzive shoqërive të automjeteve
8. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.
9. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

## Neni 5

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë “**ULUMOTOR Albania**” SH.P.K. është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 2 kuota si vijon:

1. **Halil Ziya ULUBAŞ** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. **Mehmet Arda ULUBAŞ** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 (Pesëdhjetë mijë) Lekë që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 6

### Organet e Shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë “**ULUMOTOR Albania**” SH.P.K. janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administrator i shoqërisë, është **Z.Halil Ziya ULUBAŞ**. Shoqëria do të administrohet nga **ZHalil Ziya ULUBAŞ**, si administrator i saj, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

## Neni 7

Të drejtat e detyrat e asamblesë, organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë vendas apo të huaj, shprehen në statut, i cili bashkë me aktin e themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

## Neni 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do t'a zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.



## Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “ULUMOTOR Albania” SH.P.K. në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë. Në këtë ditë shoqëria “ULUMOTOR Albania” SH.P.K. njihet si person juridik.

## Neni 10

1. Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
2. Ortakët e shoqërisë i japin të drejtën **Z.Armand Shkurta**, të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjetër për regjistrimin e shoqërisë “ULUMOTOR Albania” SH.P.K.

### ORTAKET E SHOQERISE

Halil Ziya ULUBAŞ



Mehmet Arda ULUBAŞ

